



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1979/1 prot.

Tiranë, më 09.09.2024

Lënda: Mbi ribashkërendimin e projektligjit “Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve”

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 2418/26 prot., datë 29.08.2024, protokolluar me tonën me nr. 1979 prot., datë 30.08.2024, me anë të së cilës dërgoni për ribashkërendim projektligjin “Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve” si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i projektligjit të ridërguar, Zyra e Komisionerit vlerëson në tërësi marrjen në konsideratë të sugjerimeve të dhëna nga ana jonë me shkresën nr. 1556/1 prot., datë 02.07.2024. Megjithatë, konstatojmë dhe nuk gjejmë të reflektuar në draftin e ridërguar për mendim sugjerimin lidhur me nivelin dhe monitorimin e aksesit në databazat përkatëse.

Sikurse e kemi përcjellë dhe me shkresën e mëparshme, është sugjeruar që nga ana juaj të merren masa për rregullimin e nivelit dhe monitorimit të aksesit në databazat përkatëse. Monitorimi i aksesit dhe kërkimeve nga autoritetet kompetente është i rëndësishëm, pasi çdo institucion, në cilësinë e kontrolluesit në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, legjitimohet të aksesojë të dhëna personale, vetëm për aq sa lidhet me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së tij.

Për përmbushjen e këtij kriteri përpunimi, është e nevojshme që databaza e të dhënave të ndërtohet në mënyrë të tillë që të garantohet konfidencialiteti dhe aksesit i kufizuar në përputhje me qëllimin e përpunimit si dhe të sigurohet gjurmueshmëria për çdo ndërhyrje në këto databaza. (Ritheksojmë se ky sugjerim vjen në linjë me Nenin 6, të Direktivës (BE) 2019/1153, të cilën ky projektligj synon të përfaqëtojë).

Në përfundim, mbetet në vlerësimin tuaj nëse sugjerimet/rregullimet e përmendura më sipër, do të përfshihen në projektligj apo do të parashikohen në akte nënligjore që do të dalin në zbatim të këtij projektligji.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi